

Në përputhje me nenin 101 të Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe nenit 145 të Statutit të Komunës së Ulqinit, ne - organizatat joqeveritare të poshtëshënuara, nisim këtë:

INICIATIVË

për pagesën e mjeteve OJQ-ve nga Konkursi i vitit 2016
dhe
krijimin e kushteve formale për shpalljen e Konkursit për ndarjen e mjeteve për v. 2017

Sqarim:

Me datën 12/12/2016 Komisioni për ndarjen e mjeteve organizatave joqeveritare ka miratuar Vendimin për mbështetjen e projekteve të OJQ-ve, në bazë të Konkursit për v. 2016. Këtë vendim e ka zyrtarizuar Kabineti i Kryetarit të Komunës së Ulqinit me datën 15/12/2016, Nr. 551/16.

Në bazë të këtij vendimi, me 29/12/2016 Komuna e Ulqinit ka nënshkruar kontratat me organizatat joqeveritare për financimin e projekteve të mbështetur në Konkursin 2016.

Në përputhje me nenin 4 të këtyre kontratave, Komuna është angazhuar të paguaj shumat për financimin e projekteve, në afat prej 30 ditësh nga dita e nënshkrimit të tyre. Pra Komuna ka qenë e obliguar t'iu paguaj mjetet OJQ-ve deri me **29 janar 2017**.

Duke marrë parasysh këtë vonesë të Komunës, OJQ-të lokale nuk mund t'i realizojnë projektet tyre. Gjithashtu duhet të theksojmë se shumica e projekteve të mbështetura në Konkursin nga v. 2016, janë planifikuar të realizohen përpara sezonit veror.

Sipas Vendimit për kriteret dhe mënyrën e ndarjes së mjeteve OJQ-ve (Fl. Zyrtare e MZ nr. 37/2014), neni 5, parashihet që "Konkursi publik për ndarjen e mjeteve shpallet 30 ditë prej ditës së aprovimit të Buxhetit të Komunës". Pra, duke llogaritur që Buxheti i Komunës është miratuar në mbledhjen e Parlamentit Lokal me 28/12/2016, konkludojmë se Komuna vonohet në shlyerjen e obligimit të financimit të projekteve të organizatave të shoqërisë civile, me rëndësi për komunitetin lokal.

Gjithashtu përmendim se shumica e komunave në Mal të Zi, procedurën e shpalljes dhe realizimit të konkurseve për v. 2017 e kanë kryer ose janë në fazën e realizimi.

Nisur nga këto fakte, Ju propozojmë që pagesat për projektet e mbështetura nga Konkursi 2016, duhet t'i kryeni sa më parë, në mënyrë që të krijohen kushtet formale për të shpallur konkursin publik për vitin 2017.

Duke shpresuar që Ju personalisht do të angazhoheni për krijimin e një ambienti sa më të favorshëm për veprimin e OJQ-ve dhe me këtë të kontribuoni në përmirësimin cilësor të komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet Qeverisjes Vendore dhe Sektorit Civil.

Me respekt,

RRJETI JOFORMAL I ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE – ULQIN

Me respekt,